URDHËR
Nr. 188, datë 24.7.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI DISA KËRKESA SHTESË NË TREGTINË E GJEDHIT LIDHUR ME RHINOTRAKEITIN INFEKTIV TË TIJ"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 34 të ligjit nr. 10 465 datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi disa kërkesa shtesë në tregtinë e gjedhit lidhur me rhinotrakeitin infektiv të tij".
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

RREGULLORE
MBI DISA KËRKESA SHTESË NË TREGTINË E GJEDHIT LIDHUR ME RHINOTRAKEITIN INFEKTIV TË TIJ

Neni 1

Kërkesat shtesë për kafshët gjedhë që hyjnë në territorin e Shqipërisë nga vende të tjera nga ato të listuara në shtojcën I.

1. Kafshët gjedhë për mbarështim dhe prodhim që hyjnë në territorin e Shqipërisë, duhet të plotësojnë të paktën këto kërkesa shtesë lidhur me sëmundjen e rhinotrakeitit:

a) duhet të vijnë nga një fermë në të cilën, sipas informacionit zyrtar, nuk janë regjistruar për të paktën 12 muaj, shenja klinike apo patologjike të pranisë së rhinotrakeitit infektiv;

b) të jenë izoluar menjëherë para lëvizjes, për 30 ditë në një objekt të miratuar nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës, dhe të gjitha kafshët e tjera gjedhë në këtë objekt izolimi gjatë kësaj periudhe, duhet të jenë të lira nga shenjat klinike të rhinotrakeitit infektiv;

c) ato dhe të gjitha kafshët e tjera gjedhë që ndodhen në të njëjtin objekt izolimi, duhet të rezultojnë negative ndaj testit serollogjik, për zbulimin e antitrupave si më poshtë, të kryer në kampione gjaku të marra jo më parë se 21 ditë, pas mbërritjes në objektin e izolimit:

i) në rastin e kafshëve gjedhë të vaksinuar, për antitrupa kundër gE-glykoproteinë të BHV1;

ii) në rastin e kafshëve gjedhë të pavaksinuar, për antitrupat kundër BHV1 të plotë.

2. Pavarësisht nga përcaktimi në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent i vendit të origjinës, mund të autorizojë largimin nga ferma të kafshëve gjedhë, kur ato plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) kafshët vijnë nga një fermë e origjinës, të lirë nga BHV1, që plotëson të paktën kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të kësaj rregulloreje;

b) kafshët janë të destinuara për prodhim mishi dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i) kafshët, ose:

- origjinojnë nga një fermë e lirë nga BHV1, sipas përcaktimit në shtojcën II;

- vijnë nga mëma të vaksinuara dhe të rivaksinuara rregullisht;

- kanë qenë të vaksinuara dhe të rivaksinuara rregullisht, në përputhje me instruksionet e përcaktuara nga prodhuesit me vaksinë gE- të fshirë;

- në vendin e origjinës kafshët i janë nënshtruar një testi serollogjik të kryer në kampione gjaku të marra brenda 14 ditëve të largimit dhe rezultojnë negative për antitrupa, sipas përcaktimit të pikës 1(c) të këtij neni;

ii) janë transportuar pa pasur kontakt me kafshë me status më të ulët të shëndetit;

iii) në përputhje me një program kombëtar çrrënjosjeje, kafshët janë mbajtur për majmëri në vende të mbyllura nga të cilat ato mundet të transportohen vetëm direkt në thertore;

c) kafshët origjinojnë nga ferma në të cilat të gjitha kafshët gjedhë më të mëdha se 15 muaj janë vaksinuar e rivaksinuar rregullisht dhe të gjitha kafshët gjedhë mbi 9 muaj u janë nënshtruar një testi serollogjik me rezultate negative për antitrupa kundër gE-glukoprotein për BHV1 në interval jo më shumë se 12 muaj. Gjithashtu, kafshët janë testuar mbi kampione gjaku të marra 14 ditë para dërgimit dhe kanë rezultuar negative për antitrupa sipas përcaktimit në pikën 1(c) (i);

d) kafshët origjinojnë nga një fermë e lirë nga BHV1, siç përcaktohet në shtojcën II të një vendi, në të cilin sëmundja e rhinotrakeitit infektiv të gjedhit është sëmundje detyrimisht e lajmërueshme dhe në një rreze 5 km rreth fermës nuk evidentohen shenja klinike ose patollogjike të infeksionit BHV1 gjatë 30 ditëve të fundit. Gjithashtu, kafshët janë testuar mbi kampione gjaku të marra gjatë 14 ditëve para dërgimit dhe rezultojnë negative për antitrupa sipas paragrafit 1(c);

3. Kafshët gjedhë për therje që vijnë nga vende apo rajone të tyre me rezultate negative për antitrupa sipas paragrafit 1(c), transportohen drejtpërdrejt në thertoren e destinacionit ose në një qendër grumbullimi të miratuar sipas nenit 11 të urdhrit të Ministrit nr. 255, datë 10.6.2008 “Për miratimin e rregullores “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave” dhe lëvizja e tyre në thertore, për therje bëhet në përputhje me përcaktimin në nenin 7 pika 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Kërkesat shtesë në lëvizjen e kafshëve të llojit gjedh lidhur me sëmundjen e rhinotrakeitit

1. Kafshët gjedhë për mbarështim dhe prodhim që vijnë nga vende apo rajone të tyre, të tjera nga ato të listuara në shtojcën I të kësaj rregullore, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 1(1)(a) dhe (b);

b) ato dhe të gjitha kafshët e tjera gjedhë që ndodhen në të njëjtin objekt izolimi, sipas përcaktimit në nenin 1(1)(b), pas nënshtrimit të testit serollogjik të kryer në kampione gjaku të marra jo më parë se 21 ditë pas arritjes së tyre në objektin e izolimit, të rezultojnë negative për rizbulimin e antitrupave kundër BHV1 të plotë;

c) nuk duhet të jenë vaksinuar kundër rhinotrakeitit infektiv të gjedhit.

2. Kafshët gjedhë për therje që vijnë nga vende ose rajone të tyre, të tjera nga ato të listuara në shtojcën I, duhet të transportohen drejtpërsëdrejti në thertoren e destinacionit për therje në përputhje me nenin 7, paragrafi 1 të urdhrit të Ministrit nr. 255, datë 10.6.2008 “Për miratimin e rregullores “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave””.

Neni 3

Kërkesat shtesë për kafshët gjedhë që hyjnë në territorin e Shqipërisë nga vende të tjera nga ato të listuara në shtojcën I

Kafshët gjedhë për mbarështim dhe prodhim me origjinë nga vende apo rajone të tyre, të listuara në shtojcën I, që hyjnë në territorin e vendit tonë, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1(1)(a).

Neni 4
Testet serollogjike

Autoriteti kompetent i vendit të origjinës, siguron që testi serollogjik i përcaktuar në nenin 1 (1) (c) (ii) dhe në nenin 2(1)(b), për zbulimin e antitrupave kundër BHV1, i plotë, është standardizuar kundrejt serumeve pozitive të forta, pozitive të dobta dhe negative, sipas standardeve ndërkombëtare të OIE për testet e BHV1.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

SHTOJCA I
RAJONET E SHTETEVE ANËTARE NË TË CILAT ZBATOHEN KËRKESAT SHTESË PËR RHINOTRAKEITIN INFEKTIV TË GJEDHIT

Danimarkë - Të gjitha rajonet
Itali - Provinca e Bolzanos
Austria - Të gjitha rajonet
Finlandë - Të gjitha rajonet
Suedi - Të gjitha rajonet
Gjermani - Të gjitha rajonet

SHTOJCA II
FERMAT E LIRA NGA BHV1

1. Një fermë gjedhi do të konsiderohet e lirë nga infeksioni BHV1, nëse përputhet me kushtet e mëposhtme:

1.1 nuk janë regjistruar dyshime për infeksionin BHV1 në fermë, gjatë gjashtë muajve të fundit dhe të gjitha kafshët gjedhë në fermë nuk paraqesin simptoma klinike treguese për infeksionin BHV1;

1.2 në fermë janë futur vetëm kafshë gjedhë nga ferma të vendosura në vende apo rajone të listuara në shtojcën I dhe asnjë kafshë në këto ferma nuk ka pasur kontakt me kafshë të tjera;

1.3 kafshët gjedhë femra janë inseminuar vetëm me:

- spermë nga dema prodhues në përputhje me urdhrin e Ministrit nr. 406, datë 15.11.2007, për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kërkesave të shëndetit të kafshëve që zbatohen në tregtimin e importin e spermës së kafshëve shtëpiake të llojit gjedhë”, dhe të cilët janë testuar me rezultate negative për antitrupa sipas nenit 1(1)(c)(i) të kësaj rregulloreje; ose
- është shërbyer nga dema që vijnë nga ferma të vendosura në shtetet apo rajone të tyre, të përcaktuara në listën e shtojcës I ose nga ferma të lira nga BHV1;

1.4 të paktën një nga rregullat e mëposhtme është zbatuar në fermë:

1.4.1 një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje është kryer me rezultate negative në secilin rast, të paktën në dy kampionime gjaku të marra në interval kohor 5 deri në 7 muaj, nga të gjitha kafshët gjedhë femra dhe meshkuj të përdorura ose të destinuara për qëllime

mbarështimi, në moshë më të mëdhenj se 9 muaj;

1.4.2 një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa kundër BHV1, është kryer me rezultate negative, të paktën në dy kampionime individuale qumështi ose në një rezervë qumështi të marrë në jo më shumë se 5 kafshë, në interval kohor 5 deri në 7 muaj nga të gjitha kafshët në laktacion;

1.4.3 një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, është kryer me rezultate negative në secilin rast, të paktën në dy kampionime gjaku të marra në interval kohor 5 deri në 7 muaj nga të gjitha kafshët gjedhë femra jo në laktacion, si dhe nga të gjitha kafshët meshkuj të përdorura ose të destinuara për qëllime mbarështimi në moshë më të mëdhenj se 9 muaj;

1.4.4 në rastin e fermave të qumështit në të cilat të paktën 30% të kafshëve gjedhë femra janë në laktacion, një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa kundër BHV1, është kryer me rezultate negative në secilin rast mbi të paktën tri kampionime qumështi të mbledhura, në varësi të specifikimit të testit të përdorur, nga një numër jo më të madh se 50 kafshë, të marra në një interval kohor të paktën 3 muaj;

1.4.5 një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, është kryer me rezultate negative në secilin rast të paktën në një kampionim gjaku të marrë nga të gjitha kafshët gjedhë femra jo në laktacion dhe nga të gjitha kafshët gjedhë meshkuj të përdorura ose të destinuara për qëllime mbarështimi në moshë më të mëdha se 9 muaj;

1.4.6 të gjitha kafshët gjedhë në fermë origjinojnë ose nga ferma të vendosura në shtete apo rajone të tyre të listuara në shtojcën I ose nga ferma të lira nga BHV1;

2. Statusi i lirë nga BHV1 për një fermë të kafshëve gjedhë ruhet nëse:

2.1 kushtet e përcaktuara në paragrafin 1.1. deri në paragrafin 1.3 më lart, vazhdojnë të zbatohen;

2.2 zbatohen të paktën një nga kërkesat e mëposhtme:

2.2.1 të gjitha kafshët gjedhë të fermës më të mëdha se 24 muaj, kanë reaguar me rezultate negative në një test serollogjik për zbulimin e antitrupave sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, të kryer në një kampionim gjaku të marrë në interval kohor jo më shumë se 12 muaj;

2.2.2 mbikëqyrja serollogjike për antitrupa kundër BHV1, është kryer me rezultate negative të paktën në një kampionim individual qumështi ose në një rezervë qumështi të marrë në jo më shumë se 5 kafshë në interval kohor prej 12 muaj, nga të gjitha kafshët në laktacion e të gjithë kafshët gjedhë femra jo në laktacion;

të gjitha kafshët meshkuj në fermë më të mëdhenj se 24 muaj, kanë reaguar me rezultate negative në një test serollogjik për zbulimin e antitrupave sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, të kryer në një kampionim gjaku të marrë në interval kohor jo më shumë se 12 muaj;

2.2.3 në rastin e fermave të qumështit, në të cilat të paktën 30% e kafshëve gjedhë femra janë në laktacion, një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa kundër BHV1, është kryer me rezultate negative në secilin rast mbi të paktën dy kampionime qumështi të mbledhura, në varësi të specifikimit të testit të përdorur, nga një sasi jo më të madhe se 50 kafshësh të marra në një interval kohor jo më pak 3 muaj dhe jo më shumë se 12 muaj;

një mbikëqyrje serollogjike për antitrupa sipas nenit 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, është kryer me rezultate negative në secilin rast të paktën në një kampionim gjaku të marrë nga të gjitha kafshët gjedhë femra jo në laktacion dhe gjedhët meshkuj në fermë më të mëdhenj se 24 muaj në interval kohor jo më shumë se 12 muaj;

3. Statusi i lirë nga BHV1, për një fermë kafshësh gjedhë pezullohet, kur gjatë një kontrolli sipas paragrafit 2.2.1 deri në 2.2.3 më lart, një kafshë reagon me rezultat pozitiv në një test për antitrupa sipas nenit 2(1)(c) të kësaj rregulloreje;

4. Statusi i lirë nga BHV1, i pezulluar në përputhje me pikën 3 më lart, rikthehet vetëm pasi kontrolli serollogjik është kryer me rezultate negative në secilin nga dy raste në interval kohor të paktën dy muaj dhe të filluara jo më shpejt se 30 ditë pas largimit të kafshëve seropozitive të cilat përfshijnë:

- testimin serollogjik për antitrupa sipas neni 1(1)(c) të kësaj rregulloreje, për të gjitha kafshët gjedhë në fermë të kryer në kampione gjaku; ose

- në rastin e lopëve në laktacion, testimin për antitrupa kundër BHV1, të kryer në kampionim individual ose të grupuara kampionesh qumështi të marra nga jo më shumë se pesë kafshë.